

AGJENDA E PUNËTORISË UHZ–FERD

Nga partneriteti te bashkëkrijimi: Rajoni si partner në profilizimin e Universitetit “Haxhi Zeka”

Data: 28 gusht 2026	Vendi: Salla e Senatit, Universiteti “Haxhi Zeka”, Pejë	Ora: 10:00
----------------------------	--	-------------------

Koha	Tema / Aktiviteti	Përmbajtja dhe pyetjet orientuese
10:00–10:10	Hapja – FERD në një fazë të re	Hyrje nga UHZ: Nga FERD si forum për zhvillimin ekonomik rajonal te FERD si mekanizëm i përhershëm i dialogut dhe bashkëkrijimit Universitet–Komuna–Biznes–Shoqëri Civile. Pse FERD duhet të marrë një rol të ri në profilizimin e UHZ-së dhe zhvillimin e rajonit? Folës: Prof. dr. Armand KRASNIQI Rektor
10:10–10:35	Diskutimi I – Çfarë Universiteti i duhet rajonit?	Cilat janë sfidat kryesore ekonomike dhe zhvillimore të komunave? Cilët sektorë kanë potencialin më të madh? Çfarë profilesh dhe shkathtësish do t'i nevojiten rajonit deri në vitin 2030? Në cilat fusha duhet të profilizohet më fuqishëm UHZ? Diskutim i përbashkët/ Presim diskutimin e secilit përfaqësues të komunës lidhure me temën
10:35–11:00	Diskutimi II – Nga të dhënat te vendimmarrja: UHZ si partner kërkimor i komunave	Prezantim i shkurtër i iniciativës së Institutit për Shkencë dhe Arte për studimet e fizibilitetit dhe matricën e analizave komunale. Çfarë duhet të hulumtojë UHZ për komunat? Çfarë të dhënash mund të ofrojnë komunat? Diskutim për krijimin e Barometrit Ekonomik dhe Zhvillimor të Rajonit të Dukagjinit – UHZ/FERD. Folës: Prof. ass. dr. Elvis ELEZAJ
11:00–11:35	Diskutimi III – Nga diploma te kompetenca: çfarë studenti duhet t'i ofrojë UHZ rajonit?	Cilat shkathtësi kërkojnë institucionet dhe ekonomia lokale? Si mund të lidhen nevojat e rajonit me programet studimore? Si të zhvillohet mësimi i bazuar në praktikë? Si të institucionalizohet praktika në komuna, ndërmarrje publike, biznese dhe OJQ? Nevojat e rajonit → shkathtësitë → programet → mësimi praktik → praktika → punësimi. Folës: Prof. asoc. dr. Alma Shehu Lokaj Prorektore
11:35–12:00	Diskutimi IV – Nga partneriteti formal te bashkë krijimi	Çfarë roli konkret duhet të kenë komunat, bizneset, odat ekonomike, asociacionet profesionale dhe OJQ-të në profilizimin e UHZ-së? Si mund të përfshihen partnerët në

		zhvillimin/rishikimin e programeve, kërkimin shkencor, projektet, mësimin praktik dhe bordet industriale? Diskutim i përbashkët lidhur me temën
12:00–12:20	Nga Workshop-i te Konferenca IV e FERD-it	Çfarë duhet të diskutojë dhe, mbi të gjitha, çfarë duhet të prodhojë Konferenca IV? Identifikimi i temave prioritare: profilizimi i universiteteve publike; universiteti dhe zhvillimi rajonal; kërkimi i bazuar në nevojat e rajonit; shkathtësitë, praktika dhe punësueshmëria; modeli FERD 2030. Diskutim i përbashkët dhe propozimet
12:20–12:35	Përfundimet – Nga diskutimi te angazhimi	Dakordimi mbi: (1) drejtimin e ri të FERD-it; (2) prioritetet që duhet të adresojë UHZ; (3) bashkëpunimin UHZ–Komuna për kërkim dhe fizibilitet; (4) hartëzimin e shkathtësive dhe praktikës; (5) objektivat dhe temat e Konferencës VI të FERD-it Diskutim i përbashkët / propozime
12:35–13:00	Rrjetëzimi & diskutime bilaterale	Hapësirë për komunikim ndërmjet UHZ-së, komunave dhe partnerëve; identifikim të iniciativave konkrete dhe koordinim për hapat pasues.
	Prezantimi dhe ndarja e Draftit të Planit Strategjik të UHZ-së	Ndarja e Draftit të Planit Strategjik të UHZ-së me komunat dhe partnerët pjesëmarrës, me qëllim të marrjes së komenteve, propozimeve dhe rekomandimeve për pasurimin e dokumentit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.
13:00	Drekë	Drekë e përbashkët për pjesëmarrësit.

Mesazhi udhëheqës i punëtorisë

“Universiteti nuk mund të profilizohet i ndarë nga rajoni ku vepron. Rajoni nuk duhet të jetë vetëm përfitues i dijes së Universitetit, por partner në krijimin e saj.”

Nga FERD 1.0 te FERD 2.0

Nga forum për zhvillimin ekonomik rajonal → në mekanizëm të përhershëm të bashkëkrijimit ndërmjet Universitetit, institucioneve publike, biznesit dhe shoqërisë civile për profilizimin e UHZ-së, zhvillimin e rajonit dhe përgatitjen e studentëve për jetën profesionale.